



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-22972
Data/Datum 18.08.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET:

KOMUNËS SË GJAKOVËS

DHE

EDUCATION COMES FIRST

Neni 1
Përfaqësimi i palëve

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje garantojnë se ata kanë autorizimet e nevojshme për përmbushjen e obligimeve nga ky memorandum bashkëpunimi, se nënshkruesit e memorandumit të bashkëpunimit kanë zotësinë juridike për lidhje dhe nënshkrimin e së njëjtës në emër dhe për llogari të të njëjtëve, dhe se lidhja dhe përmbushja e obligimeve që dalin kjo marrëveshje është e lejuar më ligj.

Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

1. Komuna e Gjakovës (në vijim "Komuna"), me adresë në Rr. Nëna Tereze, Gjakovë 50000, Republika e Kosovës, përfaqësohet nga Kryetari i Komunës – Ardian Gjini.
2. Education Comes First, me adresë në Rr. Agim Haxhiavdyli p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 5115762-1 si dhe numrin fiskal 601544233, përfaqësohet nga Drejtoresha Ekzekutive – Delvina Hajdari.

Më tutje në tekst: PALËT.

Neni 2
Qëllimet

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim të krijoj bashkëpunim në mes të Komunës dhe Education Comes First në promovimin e të drejtave të fëmijës dhe gjithëpërfshirjes sociale.

2. Përmes këtij memorandumi të bashkëpunimit synohet realizimi i përbashkët i projektit "Minimaratona 3 km "VRAPO PËR PAQE" në bashkëpunim me Forum ZFD. Ky aktivitet do të mbahet me datën 18 Shtator 2021 dhe ka qëllim ngritjen e fondeve për krijimin e këndit të lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuara në Komunën e Gjakovës.
3. Palët do të bashkëpunojnë rreth mundësisë së përfshirjes të fëmijëve dhe nxënësve të Komunës së Gjakovës, duke përfshirë edhe grupet e marginalizuara, në garën e vrapimit që do të realizohet në dy kategori: 1.5 km për fëmijët e moshës 4 deri në 8 vjet (të cilët mund të shoqërohen me prindërit, kujdestarët dhe të rriturit), dhe kategoria 3 km për fëmijët mbi moshën 8 vjet, adoleshentët dhe të rriturit deri në 18 vjeç.

Neni 3 Fushat e bashkëpunimit

Palët dakordohen të bashkëpunojnë në lidhje me fushat e mëposhtme:

1. Promovimi i të drejtave të fëmijëve, krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në shënimin e përvjetorit të Konventës për të drejtat e fëmijëve.
2. Krijimin e kanaleve të komunikimit në mes të Komunës, Shkollave dhe Organizatave joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe promovimin e jetës së shëndetshme.
3. Informimin e prindërve rreth aktivitetit dhe mundësisë së pjesëmarrjes së fëmijëve në këtë aktivitet.
4. Angazhimin për shtrirjen e projektit në të gjitha mjediset me theks të veçantë Institucionet edukativo-arsimore (niveli fillor dhe i mesëm i ultë) të Komunës së Gjakovës.

Neni 4 Obligimet e palëve

Sipas këtij memorandumi palët pranojnë përgjegjësitë dhe obligohen si vijon:

1. Obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës përfshijnë:
 - a) Asistim në organizimin e takimit informues me Drejtorinë e Arsimit, drejtorat e shkollave dhe Institucioneve Parashkollore.
 - b) Angazhimin në promovimin e aktivitetit dhe inkurajimin për pjesëmarrje të fëmijëve dhe nxënësve të të gjitha shkollave të Komunës së Gjakovës, përgatitjen e komunikatës për media dhe promovimin në media/ rrjetet sociale të Komunës.
 - c) Asistimin në shtypjen e broshurave/banerave sensibilizuese për garën dhe numrave për pjesëmarrje në garë.
 - d) Mbështetjen në realizimin teknik dhe logjistik të garës në qytet, në sigurimin e rrugës nga Pallati i Kulturës "Asim Vokshi" në Transit me datën 18 Shtator 2021 nga ora 10.00.
 - e) Sigurimin e policisë dhe ambullantës në mbarëvajtjen dhe kujdesin për garuesit gjatë garës.
 - f) Ofrimin e hapësirës së Pallatit të Kulturës "Asim Vokshi" për shpërndarjen e numrave gjatë kampanjës si dhe ditën e garës.
 - g) Asistim në krijimin e hapësirës së përshtatshme për ndarjen e shpërblimeve për fituesit e garës në dy kategoritë.
 - h) Prezenca dhe ndarja e çmimit për fituesin nga Kryetari i Komunës së Gjakovës.
 - i) Asistimin në krijimin e grupit vullnetar në takimet individuale me bizneset potenciale për të shikuar mundësitë e ngritjes së fondeve në ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuara në qytetin e Gjakovës.
 - j) Asistim në identifikimin e hapësirës së përshtatshme për krijimin e këndit të lojërave.

2. Obligimet dhe përgjegjësitë e Education Comes First përfshijnë:

- a) Kordinimin e aktiviteteve të përbashkëta për informimin dhe promovimin e aktivitetit tek të gjitha palët.
- b) Organizimin e takimeve me shkollat, njoftimin dhe inkurajimin për pjesëmarrje në garë.
- c) Organizimin dhe mbikqyrjen gjatë garës, sigurimin e grupit të vullnetarëve për mbështetje gjatë garës.
- d) Promovimin e aktivitetit në media, rrjetet sociale, pjesëmarrja në intervista.
- e) Shpërndarjen dhe shitjen e numrave për garë.
- f) Përgatitjen e materialeve për promovimin e aktivitetit, vendosjen dhe shpërndarjen e tyre në shkolla dhe përgjatë rrugës ku zhvillohet gara.
- g) Angazhimin në ngritjen e fondeve për ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuara në qytetin e Gjakovës.
- h) Koordinimin me Federatën e Atletikës së Kosovës për matjet e kohës së garuesve përgjatë garës si dhe bashkëpunimin në sigurimin e medaljeve dhe mirënjohjeve për garuesit.

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm mes tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në mënyrë verbale dhe elektronike.
2. Palët do të caktojnë personat kontaktues që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informatave dhe plotësimin të kërkesave të tyre për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit.
3. Palët do të informojnë njëri-tjetrin mbi personat e kontaktit jo më vonë se dy (2) javë nga nënshkrimi i këtij Memorandumi.
4. Personat kontaktues nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikim dhe koordinim, me qëllim të dakordimit për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 6

Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Palët nënshkruese të këtij memorandumit pajtohen që ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të zgjasë për një periudhë deri në përfundim të projektit.

Neni 7

Shkëputja e Memorandumit të Bashkëpunimit

1. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të shkëputet para afatit të skadimit në marrëveshje nga të dyja palët, apo me kërkesë të njëres palë, me lajmërim paraprak me shkrim në afatin prej dy (2) javësh.
2. Ky memorandum i bashkëpunimit është i bazuar më mirëbesim dhe nuk ka për qëllim të përfitojnë palët të treta. Shkëputja mund të ndodhë në rastin nëse cila do palë është dëmtuar materialisht me veprime të qëllimshme apo nga pakujdesia e palës tjetër.
3. Kjo marrëveshje nuk parasheh implikime financiare në mes të dy palëve.

Neni 8
Gjuha e përdorur

1. Dokumenti i memorandumit të bashkëpunimit në mes Komunës dhe Education Comes First është shkruar në gjuhën shqipe.
2. Sipas nevojave të palëve memorandumit mund të përkthehet edhe në gjuhën serbe apo angleze, me pëlqimin paraprak të palëve.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky memorandum nënshkruhet me datë _____ në Gjakovë dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 10
Dispozitat kalimtare

1. Ky memorandum i bashkëpunimit rregullohet sipas dispozitave të ligjeve në fuqi në Kosovë.
2. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e palëve, dhe kërkesa për modifikim duhet të dorëzohet te pala tjetër së paku dy (2) javë para datës së synuar të modifikimit.
3. Ky memorandum i bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën prej palëve.

Education Comes First



Drejtoreshë Ekzekutive
Delvina Hajdari

Gjakovë, me: _____

Komuna e Gjakovës



Kryetari i Komunës
Ardian Gjini

Gjakovë, me: 18.08.2021